10. Përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

Musa Cena - Në pyetjen e kuvendarit Burim Krasniqi lidhur me Rregulloren mbi fillim dhe mbarimin e orareve të punës, do t'i dërgojë përgjigje me shkrim..

Xhemali Haxhimustafa – Mos po mbesim as me shkrim e as me gojë. E harrojnë këta mirë e keni.

Përparim Krasniqi – Ka qenë një pyetje nga Labinot Berisha për rrugën regjionale Kramovik – Xërxe. Në vitin e kaluar i kemi dërguar 2 kërkesa Ministristrisë e infrastrukturës, këtë vit i kemi rikthyer edhe një herë ato parashtresa për shtrimin e rrugës, po ashtu kemi pasur takime edhe me ministrin Mujota për atë rrugë bashkë me Kryetarin dhe shpresoj që këtë vit do të merren hapa në meremetimin e kësaj rruge.

Rexhep Oruqi – Desha ti drejtohem Kryetarit të komunës sepse është ndoshta e treta herë radhazi që po e inicion dhe potencon çështjen e masakrës së pronës shoqërore, pronës së Kuvendit të Komunës. Është përmendur 2–3 herë edhe më herët pikërisht në këtë sallë dhe ndoshta kishte qenë mirë meqenëse ai e ka mandatin, i ka kompetencat, i ka shërbimet le të na i ofron të gjitha lëndë të dyshimta që është keqpërdorur prona shoqërore, prona e Komunës. Le të njoftohet Kuvendi me të gjitha rastet bile, bile nuk ka qenë mirë që është iniciuar çështja në Prokurori pa u njoftuar ky Kuvend. Nëse jemi titullar të pronës shoqërore atëherë bile me ato raste të njihemi e jo të shkojmë si në formë kërcënuese që e treta herë që po përsëritet dikush e ka bërë në këtë mandat ashtu dikush, në këtë mandat kështu, jo krejt po dikush. Po le të dalin me emra se dokumenti nuk mund të fshihet. Dokumentet janë në ndërtesë të Komunës le të del secili rast veç e veç edhe ky Kuvend le të debatoj.

Rasim Fazliu – pyetje për Kryetarin: në bisedë me shumë arsimtarë të Komunës së Rahovecit që udhëtojnë, e dimë që Ligji nuk i obligon për pagesë, mirëpo kam dëgjuar që komunat të tjera po e paguajnë si ajo e Prizrenit. Nëse Komuna jonë ka mjete buxhetore 30%, 40% apo sado, do të ishte mirë të gjithë atyre personave që udhëtojnë me ju dal në ndihmë.

Fatmir Kadiri – Kryetar unë qe 4 muaj po bëjë pyetje po nuk po më përgjigjet drejtori juaj. Kur është bërë kompensimi me Fadil Gashin, gropa septike që është mbaruar në Xërxe. Fadil Gashi i ka ofruar do parcela të vogla e për ato parcela të vogla drejtori juaj nuk po më jep përgjigje ende. A janë të bartura në komasacion ato parcela pra a i kanë bartur atë komasacion prej kësaj are të madhe në atë të vogël.

Rukije Krasniqi – E kam një pyetje dhe një propozim. Kemi disa kërkesa nga disa nxënës dhe prindër nga Shkolla fillore "Bajram Curri" meqenëse jam e lindur në K. të Madhe dhe kërkojnë vendosjen e pengesave në të dy anët e rrugës afër rrugës së shkollës sepse shpejtësia e automjeteve është shumë e madhe.

Pyetja tjetër: Çka po ndodhë me objektet me qira që janë në oborret e shkollës, kujt i përgjigjen ata, DKA-së apo drejtorisë së shkollave përkatëse?

Labinot Berisha – Sa i përket çështjes së pronës, kërkoj që gjatë këtij viti njëra nga seanca të jetë me dyer të mbyllura sepse të gjithë jemi dëshmitar që nga lokalitetet që vijmë ajo pronë është masakruar, pra nëse nisemi nga qendra fshatit edhe përreth fshatit. Ky është një rekomandim po sigurisht do të bëhet dikur kur do të ketë mundësi.

-Në fshatin Denjë në Shkollë fillore është një murrë përball dhe është i hapur ashtu që xhamat që janë në të janë rrezik të rrëzohen dhe e di që ka fëmijë shumë, kështu që është rrezik i tyre. E di që gjatë gushtit të vitit të kaluar një kompani ka shkuar të punoj aty, mirëpo nga ushtruesi i detyrës së drejtorit nuk është nënshkruar asgjë pasi që punimet nuk kanë qenë ashtu si duhet. Pra prapë ajo situatë ka mbetur pa u ndryshuar. Ndoshta nuk jeni të informuar por është një çështje shqetësuese për sigurinë e fëmijëve.

Avdullah Kryeziu – me vendim të Kuvendit Komunal janë rregulluar zyre të partive politike në Rahovec dhe fatmirësisht në ato zyre janë vendosur disa parti politike dhe priten të vendosen të tjerë, mirëpo ka mbetur një borxh i papaguar i rrymës elektrike. Shpresoj që këtë borxh Kuvendi Komunal do ta kryej dhe ne do të kemi rrymë sepse duhet të funksionojnë partitë politike ashtu si funksionon Kuvendi dhe të tjerët.

U bënë që 4 mbledhje dhe ne nuk kemi mëditje. Është vërtet shqetësuese deri sa ka qenë Kujtimi ne i kemi marr mëditjet me kohë. Nëse vazhdoni kështu do të kërkojmë votëbesimin tuaj.

Kryesuesi – në bisedë që e kemi pasur dje me Kryetarin ai ka marr për sipër që për 3 mbledhje janar-mars, në prill ti marrim në mënyrë retroaktive si dhe do paguhen mëditjet e anëtarëve të KPF.

Kujtim Popaj – Pyetja ime ka qenë se kam kërkuar që të shikohen kontratat nga operatorët të objekteve të KK-së që i kemi në shfrytëzim, sidomos jam përcaktuar në objektin e OLT- it ku kam kërkuar që në bazë të cilit vendim i është zbritur ajo qiraja. Zbritja është bërë edhe në Matrex. A janë të rregullt ata operatorë dhe si është gjendja e këtyre objekteve.

Kryetari – raporti i gjendjes së qiramarrësve dhe pronave të Komunës së Rahovecit tashmë është gati edhe në seancën e radhës ju mundeni me pa gjendjen skandaloze. Këtë e them sepse ka pasur shumë pa kontratë dhe është dashur të formohet komision i posaçëm për evidentm e borxhlive të këqij dhe të atyre që punojnë pa kontrata dhe ata

që e keqpërdorin pronën Komunale, dhe mua më vjen mirë që nuk jam në mesin e atyre drejtorëve të ri. Te Rexhep Oruqi, çështja e termit **masakër e pronave** besoni që nuk e kam shpikur unë, e kam dëgjuar prej Rexhep Oruqit, prej Ibrahim Kryeziut, Nahit Elshanit, që e kanë potencuar edhe para zgjedhjeve. Masakrimi i pronave në kuptimin e masakrës të pronës të shtratit të Drinit të Bardh, masakrën në pronat e Komunës, ju mund të shihni gjendjen faktike, ju mund të shihni që kemi problem për sigurimin e lokalitetit për tregun në qytet, sepse nuk kemi vend. Nuk di çka ka ndodhur edhe nuk dëshiroj me i ik përgjegjësisë por nuk kemi pronë. Dhe kush janë ata që e kanë bërë. Nuk dëshiroj të akuzoj askënd. Mirëpo ju ftoj të formoni komision nga Kuvendi dhe prej 1999 deri 2013 jam i gatshëm me investua në drejtim të zbardhjes së fatit të pronave të keqpërdorura, uzurpuara, shitura, marrëveshje gjyqësore, të gjitha këto. Po që se do të ishte kjo Prokurori ose Gjykatë unë do të flisja ndryshe do të përmendja edhe me emra kush janë ata që i kanë bërë këtë. Me marrje të mandatit unë e kam propozuar këtë po ju nuk po më ndihmoni, unë jam i interesuar me ja rikthyer ato prona Komunës. Çka kemi dokumente unë do t'ju ofroj dhe bashkë me ju ku të doni i qojmë. Qëndroj parimor në atë që e kamë thënë para popullit të komunës së Rahovecit para jush edhe do të përsëris në vazhdimisht dhe jam gati bashkë me ju me ec deri në fund.

Nahit Elshani – prej viteve të 90-ta e këndej e gjithë prona Komunale e cila është tjetërsuar përmes gjykatës me e ditë edhe kërkoj që një pikë e veçantë e rendit të ditës me qenë dhe me debatua ne këtu. Plotësisht pajtohem që ka masakër të pronës këtu edhe ka mafi të tokës që janë marr para lufte, paslufte, po merren edhe sot fatkeqësisht dhe me 2 dëshmitarë e bëjnë tjetërsimin e pronës e Komunës.

Kryetari – Nuk dua komente më rreth kësaj çështje, jam i përcaktuar me vendosmëri t'i hymë këtij procesi deri në fund. Formoni një komision sot apo në seancën e ardhshme ndërsa Drejtoria për gjeodezi, kadastër dhe pronë na ofron në dispozicion gjithë atë që ne mendojmë apo pak mund të na shkon mendja që është keqpërdorur, për të bërë zbardhje të plotë.

Fehim Fetoshi – I nderuari Kryesues ju lutem çështja është shumë serioze ka qenë serioze po mirë që edhe po aktualizohet. Unë jam njëri nga ata që në mbledhjet e kaluara e kam përdorur termin "Mafia e tokave"dhe prapë sot po e përsërisë, dyshoj që në Rahovec ka Mafi e tokave dhe mbaj përgjegjësi për fjalën time publike. Kolegu Oruqi dhe Elshani u ndërlidhën shumë mirë dhe esenca është e njëjtë, fakti që të gjithë po pajtohemi që disa e quajmë mafi, disa masakrim i pronave edhe këtu në një farë mënyre po ndoten edhe ata që kurrë nuk kanë gisht në këto gjëra. Përveç se e mbështes propozimin e kolegut Oruçi po edhe kërkoj që të mos shkojmë të kërkojmë për prona të huaja sepse kjo nuk do të zgjidhet kurrë. Shumë lehtë Kuvendi Komunal apo Kryetari i Komunës mund të kërkoj nga gjykata që nga fillimi i 90, nga fillimi i masave të dhunshme që të gjitha tjetërsimet e pronave Komunale me gjyq të merret një komision, të shikohet dhe të vendoset, kjo është kërkesa e imja dhe e kolegëve të mi.

Kryesuesi – Drejtoria për gjeodezi dhe pronë mund të na përgatit të gjitha ato për një kohë pak më të gjatë, minimumi 4 – 5 muaj dhe po të jetë edhe në Shtator mjafton.

Nahit Elshani – Një pyetje: për mbledhje të radhës kërkoj të na ofrohen informacione se diku 6 hektarë tokë e Komunës i është dhënë GANEXIT si kompensim, kinse i ka furnizuar serbët e H. Madhe gjatë luftës me gjëra ushqimore. Ne duam të dimë saktë a ka ndodhur kjo, si ka ndodhur kjo. Është rast konkret dhe unë jam befasuar kur e kam dëgjuar.

Fehim Fetoshi – pyetja e parashtruar në mbledhjen e **KPF, më 17.01.2012**: Në bazë të informacioneve që kam në fund të vitit 2011 në emër të projekteve çoftë edhe të pakryera, janë paguar nga Qeveria Komunale. Kërkoj përgjigje se për cilat projekte janë paguar dhe nëse kjo është bërë në bazë të cilit Ligj ? Po ashtu janë paguar dhjetë shërbyes civil për punë shtesë. Dëshiroj të di se çfarë punë shtesë janë bërë dhe në bazë të cilit vendim. Gjithashtu janë paguar edhe drejtorët për punë shtesë, kur dihet se ata janë staf politik.